



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN**

Nr. 523 Prot

Elbasan më, 06.12.2021

Lënda: Njoftim për vend të lire.

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve public të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Bletërritës- 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vëpruar;
- Të jetë në kushtë shëndetësorë që e lejojnë të kryesj detyrën
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- Të demostrojë aftësi të punës ne grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplome nga nje shkolle e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem ne profesionin e kursit te formimit profesional qe aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushen ne te cilen eshte kualifikuar;
- c) Të njohë dhe të përdore teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.
 - a) letermotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në)
 - c) kartën e indentitetit
 - d) diplomë
 - e) librezë e punës
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
 - g) çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim i gjendjes shendetesore
 - i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
 - j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
 - k) te pakten nje rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;

2. Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Dokumentet ne gjuhen e huaj duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofrimit të AFP-së brenda dates. 17.12.2021

